



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË  
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 7684 / prot.  
12

Tiranë, më 14.11.2025

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1969, datë 14.04.2025.

**SHOQËRISË “ASI RENT 2020” SH.P.K**

**Lagja “Llano Dyrmishi”, Njësia Administrative Brataj, përbri postës, Zona  
kadastrale 1265, Nr. Pasurie 478/11, Selenicë, Vlorë**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA  
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë**

Shoqëria “ASI RENT 2020” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1969, datë 14.04.2025, për mineralin gur gëlqeror, në Objektin “Brataj”, Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 4227 prot., datë 03.11.2025, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 7684 Prot., datë 05.11.2025, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1969, datë 14.04.2025, për mineralin gur gëlqeror, në Objektin “Brataj”, Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë, pasi subjekti nuk ka filluar aktivitetin minerar brenda 180 ditëve nga hyrja në fuqi e lejes.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “b” (ii) të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1969, datë 14.04.2025, për mineralin gur gëlqeror, në Objektin “Brataj”, Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1969, datë 14.04.2025, për mineralin gur gëlqeror, në Objektin "Brataj", Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**DHE**

**MINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**

**ME URDHËR PËR DELEGIM**

**ZËVENDËSMINISTRI**

**BESJAN KADIU**

